Vaksina COVID-19

Hollësi që duhet të dini për vaksinën e COVID-19*

Është e SIGURT

Vaksinat COVID-19 në përdorim janë autorizuar nga FDA dhe rekomanduar nga Komisioni Këshillimor për Praktikat e Vaksinimit i CDC.

Vaksina ka ndjekur të njëjtët hapa të testimit dhe miratimit që përdoren për të gjitha vaksinat. Ato u krijuan me shpejtësi, por asnjëherë nuk kanë anashkaluar rregullat e sigurisë. Për më tepër informacion për sigurinë e vaksinës vizitoni **mass.gov/COVIDVaccineSafety**

Është FALAS

Vaksina COVID-19 jepet falas për të gjithë njerëzit nga qeveria federale.

Mund t'ju kërkohet informacioni i sigurimit shëndetësor me qëllim që ofruesi që ju bën vaksinën të faturojë siguracionin. Megjithatë, ju nuk do të merrni faturë. Në se nuk keni siguracion, përsëri keni të drejtën e vaksinimit falas.

Nevojiten DY doza për tu vaksinuar PLOTËSISHT

Pa qenë vaksinuar plotësisht, përsëri mund ta merrni dhe përhapni COVID-19.

- **Vaksina Pfizer:** të paktën **21 ditë** pas dozës së parë
- **Vaksina Moderna:** të paktën **28 ditë** pas dozës së parë
- **Vaksina Johnson & Johnson (Janssen):** vetëm **një** dozë

Jo të gjithë vaksinohen kur vaksinoheni ju. Ndërsa e dimë se vaksinat ulin shumë rastet dhe simptomat, ne përsëri jemi duke mësuar për mbrojtjen që sigurojnë vaksinat. Vazhdoni të mbani maskën, lani duart, ruani distancën dhe shmangni grupimet edhe pasi të jeni vaksinuar plotësisht.

Dy dozat tuaja duhet të administrohen nga i NJËJTI VEND

Ju duhet ta merrni dozën e dytë të së njëjtës vaksinë në të njëjtin vend me të parin.

Përpara se të lini takimin për dozën e parë, rregulloni ose konfirmoni se kur do të lini takimin e dytë (për Pfizer dhe Moderna).

* Ky informacion u përditësua së fundi më 19/4/21 lidhur me vaksinat Moderna, Pfizer dhe Johnson & Johnson (Janssen).

Për më tepër informacion, vizitoni mass.gov/COVIDvaccine